Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-562 Datë: 28.07.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 2016), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2025 nxjerr këtë:

VENDIM

I. **Riakreditohet dhe Rivalidohet,** "Loyola-Gymnasium". Adresa: Rruga e Tranzitit -Petrovë – 20000 Prizren Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2025 deri 31.08.2028, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   a. **"Mekatronikë - Operatorë i Robotëve Industrial-Teknik i Drejtimit të PROCESEVE",** niveli i IV i KKK, kualifikim i bazuar në Kualifikime Kombëtare Profesionale, me 120 kredi AAP. Numri i kandidatëve për një (1) grup mund të jetë maksimalisht pesëmbëdhjetë (15) kandidatë për vit kalendarik.

II. Institucioni obligohet të plotësojnë kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit të parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimin: **"Mekatronikë - Operatorë i Robotëve Industrial-Teknik i Drejtimit të PROCESEVE"**, niveli i IV i edukimit, kualifikim i bazuar në Kualifikime Kombëtare Profesionale me 120 kredi AAP. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e ekspertëve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim për kualifikimet si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 02.06.2025 për kualifikimin, **"Mekatronikë - Operatorë i Robotëve Industrial-Teknik i Drejtimit të PROCESEVE"** Niveli IV i edukimit dhe vizitës së realizuar me datën 09.06.2025. Pas përfundimit të procesit vlerësues raportet janë realizuar me datë 27.06.2025. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve, janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 25.07.2025.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për rivalidim të kualifikimeve, aplikacionet për riakreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese.

AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së institucionit, "Loyola-Gymnasium", për riakreditim dhe rivalidim, si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhënave në raportet vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim për institucionin aplikues, të gjeturave në raportet vlerësuese, si dhe nga të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Institucioni "Loyola-Gymnasium".
- Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve